

Mbledhje e zgjeruar e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë



Të enjten, më 27 qershor 2019, në mjediset e Selisë së Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodhokse

Autoqefale të Shqipërisë, u zhvillua mbledhja e të gjitha organeve të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë,
President i të cilit është Kryepiskopi Anastas.

Mbledhja ishte në kuadër të përgatitjeve për pjesëmarrjen e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë në

Asamblenë e X-të Botërore të “Religions for Peace”, që do të mbahet në gusht të këtij viti në Lindau të

Gjermanisë. Në të morë pjesë të gjitha instancat e KNFSH-së: Këshilli i Presidencës, Bordi Ekzekutiv,

Departamenti i Gruas dhe Departamenti i Rinisë.



Në seancën e parë u mbledh Bordi Ekzekutiv, ku znj. Sheldiana Jano, anëtare tij, shpjegoi pesë temat që do të diskutohen në Asamble. Më pas pjesëmarrësit, gjatë një workshopi të ndarë në tri grupe, me përfaqësues nga komunitete të ndryshme fetare, diskutuan rreth këtyre temave, duke nxjerrë disa rekomandime dhe sugjerime, të cilat do të dërgohen në Asamble në emër të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.



Në seancën e dytë plenare u mbledhën për herë të parë të gjitha bordet dhe departamentet e KNFSH-së, ku relatorët e grupeve të punës referuan rreth rekomandimeve dhe sugjerimeve të dala në takimet e 20 dhe 27 qershorit 2019.



Më pas, në seancën e moderuar nga Sekretari i Përgjithshëm i KFNSH, Dr. Genti Kruja, folën drejtuesit e komuniteteve fetare që bëjnë pjesë, njëkohësisht dhe anëtarë të Këshillit të Presidencës. Fillimisht, fjalën e mori Presidenti i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, Kryepiskopi i Tiranë, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Prof. Dr. Anastasi; më pas përshëndetën edhe drejtuesit e tjerë të komuniteteve. Të gjithë vunë theksin në rëndësinë e dialogut ndërfetar, por edhe të frymës së dialogut në përgjithësi, në këto ditë ku ka kaq shumë nevojë për modelin e dialogut, si një vlerë e munguar në arenën politike në dobi të paqes sociale.

Në fund të mbledhjes, e para e këtij lloji në vendin tonë, ku u mbledhën jo vetëm drejtues të komuniteteve fetare, por dhe përfaqësues të grave dhe rinisë nga ato, u shpërndanë edhe certifikatat e pjesëmarrjes.